REPUBLIKA E KOSOVËS

ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.2.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË MINISTRISË SË FINANCAVE PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2015

Prishtinë, qershor 2016

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për t'u kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne po rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe po luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Ministrisë së Financave, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Ibrahim Gjylderen, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinioni i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga Udhëheqësi i ekipit, Blerim Kabashi dhe anëtarëve të ekipit Pleurat Isufi dhe Shqiponja Krasniqi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme 4

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm 6

2 Qeverisja 9

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli 14

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit 24

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP 25

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak 28


Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i pasqyrave vjetore financiare të Ministrisë së Financave për vitin 2015 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Falënderoj Ministrin dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2015 u ndërmor në përputhje me me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA) të sektorit publik. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 25/09/2015.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën I):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2015 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinioni

Shtojca II shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.


Opinioni i Auditorit të Përgjithshëm është:

<u>Opinion i pamodifikuar</u>

Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Formulimi i plotë i fjalëve është dhënë në hollësi në Pjesën 1.2 të këtij raporti.

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigja e Ministrit të Financave - auditimi 2015

Ministri i Financave ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PVF. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i Auditimit

Opinioni i pamodifikuar

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale, shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare si dhe shpalosjet.

Sipas mendimit tonë Pasqyrat Vjetore Financiare prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale të pranimeve dhe pagesave, si dhe të buxhetit të realizuar të Ministrisë së Financave për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullën financiare të MF-së nr. 03/2013 për pasqyrat financiare të organizatave buxhetore.

Baza për Opinionin

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave financiare të organizatave Buxhetore në Kosovë, ZAP është i pavarur nga Ministria e Financave dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit dhe personave përgjegjës për Qeverisje dhe Pasqyrat Vjetore Financiare

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarim materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e pasqyrave vjetore financiare

Përgjegjësia jonë është që ta shprehim një opinion për pasqyrat vjetore financiare në bazë të auditimit tonë. Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike dhe ta planifikojmë dhe ta kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme për atë nëse pasqyrat financiare nuk kanë keqdeklarime materiale.

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë gjithnjë një keqdeklarim material kur ajo ekziston. Keqdeklarimet mund të lindin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, ato mund të pritet që të ndikojnë vendimet e përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave vjetore financiare.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi auditimi rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në pasqyrat financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori e konsideron kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Auditimi e përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

MF duhet të veprojë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048, i ndryshuar me Ligjin nr.03/L-221, Ligjin nr.04/L-116 dhe Ligjin nr.04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF nr. 03/2013;
- Kërkesat e Ligjit të buxhetit për 2015;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€;
- Raportet për borxhet e papaguara;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit; dhe
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit

Në kontekst të PVF-ve, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto. Çështjet e ngritura në memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 23/11/2015, në lidhje me kornizën raportuese janë adresuar nga Menaxhmenti. Në draft Pasqyrat Financiare ishin të nevojshme të bëhen korrigjime financiare të cilat janë marrë parasysh nga menaxhmenti i MF-së.

Marrë parasysh çka u tha më lart, Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me rastin e dorëzimit të draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Po ashtu, në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime lidhur me PVF-të.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për MF-në që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzueseve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet. Në mënyrë të ngjashme, lista kontrolluese e vetvlerësimit që plotësohet nga të gjitha organizatat buxhetore siguron një kornizë për zhvillimin e aranzhimeve të zgjeruara të qeverisjes. Është e rëndësishme që përgjigjet e dhëna nga një organizatë individuale buxhetore të jenë të mbështetura nga dëshmitë përkatëse. Prandaj, ne e kemi aplikuar një qasje konsistente në të gjitha auditimet për ta përcaktuar cilësinë e listave kontrolluese të plotësuara për vetvlerësim dhe për ta vlerësuar saktësinë e gjendjes së paraqitur mbi qeverisjen në Kosovë.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes e pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku ne besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm, dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuara përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar si mjetë kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i MF-së. Ky është një tregues që MF ka bërë përpjekje t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe të instaloj një qeverisje efektive.

Megjithatë, zbrazëtirat në aranzhimet ekzistuese të qeverisjes në MF siç janë: mungesa e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit, mos përgatitja e planit aksional për monitorimin e rreziqeve duhet të rishikohen dhe veprime konkrete duhet të ndërmerren. Mungesa e strategjisë së institucionit shkakton paqartësi rreth misionit, vizionit dhe synimeve të organizatës si dhe i dobëson proceset strategjike dhe ato operative. Kjo mund të ndikoj edhe në cilësinë e planifikimeve buxhetore dhe të shërbimeve ndaj taksapaguesve përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Më tej, sistemi i auditimit të brendshëm si hallk kyçe e sistemit të kontrollit të brendshëm ka arritur të mbështesë menaxhmentin lidhur vlerësimin e kontrolleve të brendshme në ministri. Lista kontrolluese e vetvlerësimit e plotësuar nga MF i pasqyron këto mangësi, megjithatë nuk është janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti për adresimin e këtyre çështjeve.

2.3 Rekomandimet e vitit paraprak

Raporti ynë i auditimit të MF-së për vitin 2014 kishte rezultuar me 10 rekomandime. Deri në fund të auditimit për vitin 2015, ne kemi arritur të konfirmojmë implementimin e pesë (5) rekomandimeve, tri (3) ishin në proces dhe dy (2) rekomandime nuk ishin adresuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 1 – Mos implementimi i plotë rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

E gjetura Pjesa më e madhe e rekomandimeve të vitit të kaluar janë implementuar, megjithatë disa rekomandime ende nuk janë adresuar. Në veçanti, mangësitë lidhur me proceset e prokurimit përsëriten nga viti në vit. Këto janë pasojë e mos zbatimit të një procesi formal nga MF për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të AP-së.

Rreziku Mos implementimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta dhe mund të rezultojë me mos efikasitet të vazhdueshëm të kontrolleve apo edhe humbje financiare.

Rekomandimi 1 Ministri duhet të sigurojë që ka aplikuar një proces formal të monitorimit të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga AP, me qëllim që të mbaj llogaridhënës stafin përgjegjës për adresimin e rekomandimeve sipas afateve kohore të përcaktuara në planin e veprimit.

2.4 Lista kontrolluese e vetvlerësimit të MFK-së

Ministria e Financave ka hartuar një listë të detajuar të vetvlerësimit për organizatat buxhetore për të mbështetur aranzhimet efektive të qeverisjes. Të njëjtën listë kontrolluese të vetvlerësimit e ka plotësuar edhe MF si çdo organizatë tjetër buxhetore. Për të gjitha auditimet e ndërmarra, ne kemi testuar cilësinë e pyetësorëve të vetvlerësimit të MFK-së të dorëzuara në Ministri, duke vlerësuar nga një pyetje kyçe në secilën komponentë të listës kontrolluese. Ne kemi përmbledhur të gjeturat tona për MF-në më poshtë dhe përmbledhja e punës sonë në të gjitha auditimet do të konsolidohet në Raportin tonë Vjetor të Auditimit. Kjo nuk ka për qëllim të japë koment për cilësinë e tërë pyetësorit të dorëzuar të vetvlerësimit por do ta japë gjendjen për një numër të pyetjeve kyçe për ti mbështetur përpjekjet e MF-së në rritjen e efektivitetit të procesit dhe në zhvillimin e sistemit të MFK-së në tërësi.

Çështja 2 – Lista kontrolluese e vetvlerësimit – Prioritet i lartë

E gjetura

Si pjesë e auditimit tonë, ne i kemi shqyrtuar gjashtë pyetje kyçe të pyetësorit të vetvlerësimit në lidhje me pesë komponentë. Për pyetjet e shqyrtuara kemi gjetur se:

- strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit të institucionit nuk është hartuar. Sipas sqarimit të dhënë nga MF, dokumenti strategjik i Ministrisë është në pritje të aprovimit të strategjisë së përgjithshme të Qeverisë;
- procedurat për menaxhim të rrezikut janë vendosur, megjithatë ato duhet të përmirësohen (kjo është trajtuar në hollësi në nënkapitullin 2.5.1); dhe
- proceset e monitorimit të rregullt lidhur me progresin e arritjes së objektivave konsiderohen si të vendosura, mirëpo dëshmitë për mbështetjen e konkluzioneve në lidhje me to janë të mangëta.

E vlen të cekët që, MF në kuadër të KASH-it për vitin 2016-2018 kishte përfshirë edhe misionin, objektivat dhe prioritet e MF-së për tri vitet në vijim si dhe kishte treguar kostot operative dhe kapitale për realizimin e tyre.

Megjithatë, strategjia gjithëpërfshirëse e zhvillimit do të ofronte mbështetje më afatgjate për procesin e planifikimit operativ dhe do të lehtësonte monitorimin e progresit drejt arritjes së rezultatit të dëshiruar. Ai po ashtu jep bazën për t'i raportuar Qeverisë dhe palëve të tjera të interesuara.

Rreziku

Mungesa e strategjisë së institucionit shkakton paqartësi rreth misionit, vizionit dhe synimeve të organizatës si dhe i dobëson proceset strategjike dhe ato operative. Kjo mund të ndikoj edhe në cilësinë planifikimeve buxhetore dhe të shërbimeve ndaj taksapaguesve përmes aktiviteteve joefikase dhe joefektive.

Rekomandimi 2

Ministri duhet të iniciojë hartimin e një strategjie gjithëpërfshirëse të institucionit, e mbështetur me planin për menaxhimin e rreziqeve potenciale që do të kërcënonin arritjen e objektivave të synuara. Po ashtu, të ndërmerren masa proaktive për adresimin e fushave me mangësi të theksuara të identifikuara në listën kontrolluese të vetvlerësimit.

2.5 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit operon MF, dhe sfidat me të cilat përballet.

2.5.1 Menaxhimi i rrezikut

Të gjitha organizatat buxhetore pritet që të zbatojnë vlerësimin e rrezikut. Dispozitat e LMFPP-së si dhe Rregulla Financiare e Thesarit nr. 01-2010 përcaktojnë që ZKA është përgjegjës për zbatimin e aranzhimeve, procedurave dhe sistemeve për të siguruar përmbushjen e objektivave kyçë të organizatës dhe për të identifikuar rreziqet drejt arritjes së këtyre objektivave, si dhe për të ndërmarrë hapa për të menaxhuar ato rreziqe.

Çështja 3 - Proceset e menaxhimit të rrezikut- Prioritet i mesëm

E gjetura MF ka bërë hapa konkret në drejtim të vendosjes së sistemit për menaxhimin e rreziqeve, megjithatë nuk përpiluar planin aksional për monitorimin e gjasës së ndodhjes së atyre rreziqeve dhe ndërmarrjen e masave për ti sjell në kufirin e pranueshëm. Kjo do të evitonte pengesat potenciale në arritjen e objektivave të ministrisë. Prandaj sistemi i menaxhimit të rrezikut ka nevojë për zhvillim të mëtejmë.

Rreziku Mos i përpilimi i një plani aksional për monitorimin e procesit të menaxhimit të rreziqeve potenciale, ndikon që menaxhmenti të mos ketë informata të duhura për menaxhimin e tyre dhe kjo mund të rezultojë në mos arritjen e plotë të objektivave të përcaktuara.

Rekomandimi 3 Ministri duhet të sigurojë se do të ndërmerr veprime konkrete për azhurnimin e vazhdueshëm të planit për menaxhimin e rrezikut, në mënyrë që të vendosen edhe masat e nevojshme për shmangien eventuale apo menaxhimin efektiv të rreziqeve të identifikuara.

2.6 Sistemi i Auditimit të Brendshëm

Konkluzioni i Auditimit

MF në kuadër të saj ka të formuar Njësin e Auditimit të Brendshëm (NjAB) i cili përbëhet prej tetë (8) zyrtarësh. Kjo njësi është e organizuar në dy divizione (Divizioni për auditime në MF si dhe Divizioni për auditime jashtë MF-së[1]). Në kuadër të MF-së funksionon edhe Komiteti i Auditimit i cili përbëhet prej pesë (5) anëtarëve (Kryesuesit-nga Thesari dhe katër katër (4) anëtarëve tjerë; një nga DK, një nga ATK, një anëtar i jashtëm si dhe një nga MF).

NJAB ka përgatitur planin vjetor për vitin 2015 duke u bazuar në fushat të cilat paraqesin rrezik më të lartë si dhe planin strategjik për periudhën 2015 – 2017. Kryesuesi i Komitetit në bashkëpunim me Ministrin kanë miratuar planin e auditimit të hartuar nga NJAB-ja. Në planin vjetor janë paraparë që të realizohen gjithsej 16 auditime ku 11 prej tyre do të realizohen brenda MF-së dhe pesë (5) auditime të tjera jashtë MF-së. Për vitin 2015 NJAB kishte kryer gjithsej 17 auditime, 10 prej tyre brenda Ministrisë dhe shtatë (7) për organizata tjera buxhetore.

Përderisa edhe në kuadër të Thesarit është e formuar NjAB i cili përbëhet prej një (1) zyrtari. NJAB ka përgatitur planin vjetor për vitin 2015 duke u bazuar në fushat të cilat paraqesin rrezik më të lartë si dhe planin strategjik për periudhën 2015 – 2017.

Kryesuesi i Komitetit në bashkëpunim me Drejtorin e Thesarit kanë miratuar planin e auditimit të hartuar nga NjAB-ja. Në planin vjetor janë paraparë që të realizohen gjithsej katër (4) auditime të cilat ishin realizuar të gjitha gjatë 2015. Të dy NjAB-të në baza të rregullta kishin dërguar raportet e punës në Njësinë Qendrore Harmonizuese (NJQH).

KA në MF gjatë nëntë mujorit 2015 ka mbajtur katër (4) takime. Në këto takime është diskutuar për implementimin e rekomandimeve të dala nga raportet e Auditimit të NjAB, si dhe për rekomandimet e dala nga raporti i auditimit të ZAP-it për vitin 2014.

Ne analizuam raportet e NjAB-së dhe vërejtëm se ato kishin trajtuar çështje lidhur me përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. AB ka mbuluar fushat kryesore dhe raportet e AB-së janë të një kualiteti që ofrojnë siguri për menaxhmentin e organizatës. Përfitimi nga puna e Njësisë së Auditimit të Brendshëm është marrë në konsiderate nga menaxhmenti i MF-së për të ngritur nivelin e kontrolleve në fushat me mangësi të theksuara.

[1] Departamenti i AB i MF-së është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve të të gjitha njësive strukturale, programeve, aktiviteteve dhe proceseve në MF si dhe në SSP të cilat nuk i kanë të themeluara kapacitetet e auditimit (neni 7 pika 13)

3 Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të Qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve. Si pjesë e kësaj ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit dhe të burimeve njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

3.2 Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin

MF për vitin 2015, ka ndërmarr masa proaktive në përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit. Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen edhe më tej, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Ministrisë.

Procesi buxhetor në 2015, krahasuar me vitin 2014 është përmirësuar dukshëm. Si rezultat, buxheti final për 2015 është realizuar 97% me një përmirësim prej 5% krahasuar me vitin e kaluar. Edhe pse në këtë përqindje kanë ndikuar edhe vendimet e Qeverisë për reduktimin e fondeve në fund vit. Në aspektin e rregullimeve buxhetore MF ka ndërmarr masa konkrete për të siguruar klasifikimin e drejtë të shpenzimeve. Më tutje, bazuar në rekomandimin tonë të vitit të kaluar, me ligjin e buxhetit 2016 MF ka bartur në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale buxhetin për provizione bankare për skemat pensionale.

MF ka një numër agjencish ekzekutive si: Dogana e Kosovës (DK), Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP), dhe Njësia e Inteligjencës Financiare (NjIF), pasqyrat financiare të të cilave konsolidohen në PVF e MF-it. Procesi i konsolidimit të raporteve financiare funksionon në mënyrë efektive. Agjencitë kanë strukturën e vet menaxheriale, përmes së cilës organizohet menaxhimi i aktiviteteve të përditshme operative.

Po ashtu, edhe kontrollet në fushën e menaxhimit të mallrave dhe shërbimeve të cilat nuk kalojnë përmes proceseve të prokurimit si dhe menaxhimi i të hyrave janë efektive.

Megjithatë, prioritet i veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të shpenzimeve si për mallra dhe shërbime ashtu edhe për investime kapitale të cilat kalojnë përmes proceseve të prokurimit. Kontrollet ekzistuese në proceset e prokurimit nuk janë efektive. Me theks të veçantë, kontrollet në proceset e vlerësimit të ofertave dhe nënshkrimit të kontratave me vlerë të mëdha janë përcjell me mangësi domethënëse. Është shumë e rëndësishme që procesi i prokurimit publik të kryhet me profesionalizëm dhe në mënyrë që siguron vlerën më të mirë për paranë publike të shpenzuar.

Përkundër progresit të bërë në menaxhimin e burimeve njerëzore, kjo fushë kërkon trajtim të vazhdueshëm për t'i evituar mangësitë në mbulimin e pozitave udhëheqëse me ushtrues detyre si dhe mangësitë në organizimin dhe sistemimin e brendshëm të të punësuarve.

3.3 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për MF, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Në tabelat më poshtë, janë përfshirë edhe vlerat totale të buxhetuara dhe të realizuara si për shpenzime ashtu edhe për të hyrat nga DK dhe ATK. Megjithatë, informatat më të hollësishme lidhur me menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve nga këto dy agjenci mund t'i gjeni në raportet individuale të auditimit të cilat do të publikohen në webfaqen tonë.

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore – realizimi ndaj buxhetit (në €)[2]

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final[3]	2015 Realizimi	2014 Realizimi	2013 Realizimi
Burimet e Fondeve:	**74,350,000**	**37,949,457**	**24,207,614**	**29,296,591**	**32,365,244**
Granti i Qeverisë -Buxheti	74,074,500	36,959,786	23,412,058	28,508,889	29,716,925
Financimi nga Huamarrja	275,500	375,500	350,021	119,871	102,815
Donacionet e Jashtme	-	614,171	445,535	667,831	2,545,503

Buxheti final për 2015 ishte më i vogël se buxheti fillestar për 36,400,543€. Kjo ishte rezultat i ndryshimeve të mëposhtme buxhetore nga ana e Qeverisë:

- zvogëlimi i buxhetit për paga dhe mëditje në vlerë 18,742,208€;
- zvogëlimi i buxhetit për mallra dhe shërbime në vlerë 1,686,391€;
- zvogëlimi i buxhetit për komunali në vlerë 135,073€;
- zvogëlimi i buxhetit për subvencione dhe transfere në vlerë 12,189,622€; dhe
- zvogëlimi i buxhetit për investime kapitale në vlerë 3,647,249€.

Sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2015, në buxhetin e MF-it ishin të përfshira edhe buxhetet për kontigjencat për kompensimin veteranëve të luftës prej 10,000,000€, dhe kontigjencat për pagat e minoriteteve prej 3,019,090€. Këto fonde ishin pjesë e buxhetit final të MF-së, dhe për vitin 2015, Qeveria nuk kishte marr vendim për transferimin këtyre fondeve.

[2] Shumat në këtë tabelë janë: buxhetet dhe realizimet e MF-së së bashku me Doganë dhe ATK. Për Doganë ishin buxhetuar 8,635,000€ dhe realizuar 7,597,000€; kurse për ATK ishin buxhetuar 8,146,000€ dhe realizuar 8,079,000€ . Këto Agjencione janë mbuluar me auditime të veçanta

[3] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit në €

Përshkrimi	**Buxheti fillestar**	**Buxheti Final**	**2015 Realizimi**	**2014 Realizimi**	**2013 Realizimi**
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	**74,350,000**	**37,949,457**	**24,207,614**	**29,295,000**	**32,365,244**
Pagat dhe Mëditjet	36,270,000	17,527,792	14,369,590	14,023,000	11,973,401
Mallrat dhe Shërbimet	8,146,000	6,459,609	5,890,597	7,392,000	8,425,060
Shërbimet Komunale	489,000	353,927	342,825	401,000	446,723
Subvencione dhe Transfere	25,295,000	13,105,378	3,103,321	2,662,000	8,804,735
Investimet Kapitale	4,150,000	502,751	501,281	4,817,000	2,715,325

Buxheti i final në SIMFK vetëm për programet e MF-it (përjashtuar buxhetet për kontigjencat e përmendura më lartë) ka qenë 24,930,413€, prej tyre janë realizuar 24,207,614€ apo 97%. Kjo përqindje tregon që MF kishte një nivel të mirë të realizimit të buxhetit si në nivel të kategorive ekonomike ashtu edhe në nivel të programeve. Kjo ka rezultuar në shfrytëzim efikas të burimeve, si dhe efektivitetin e planeve të shpenzimeve.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Të hyrat

Përshkrimi

Të hyrat neto të gjeneruara nga MF në vitin 2015 ishin në total 1,250,475,821€. Këto përfshijnë të hyrat tatimore dhe jo-tatimore. Ne audituam vetëm të hyrat e grumbulluara nga Thesari dhe Administrata Qendrore e MF-it, të cilat arrinin vlerën 1,542,761€. Çështjet e ndërlidhura me të hyrat e grumbulluara nga ATK dhe DK nuk ishin pjesë e këtij auditimi. Ato janë trajtuar në raporte të veçanta të auditimit.

Tabela 4. Të hyrat e përgjithshme të grumbulluara për Buxhetin e Kosovës

Agjencioni/ Departamenti	Të hyrat bruto	Kthimet	Të hyrat neto 2015	Te hyrat neto 2014	Te hyrat neto 2013
Dogana	951,808,447	6,878,578	944,929,869	868,570,436	834,079,662
Administrata Tatimore	332,700,816	28,697,625	304,003,191	272,586,344	270,763,372
AQP	0	0	0	10,430	12,000
Thesari	1,468,297	0	1,468,297	201,100	147,600
Administrata Qendrore e MF-it	74,464	0	74,464	74,928	157,629
Totali	**1,286,052,024**	**35,576,203**	**1,250,475,821**	**1,141,443,238**	**1,105,160,263**

MF ka vendosur një sistem efikas të kontrollit që kanë të bëjnë me mbledhjen dhe raportimin e të hyrave. Regjistrimi i të hyrave është bërë sipas procedurave dhe kërkesave ligjore. Janë bërë harmonizime të rregullta me raportet bankare dhe se të njëjtat janë regjistruar në SIMFK dhe klasifikuar në kode përkatëse ekonomike.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Prokurimi

Rregullat e Prokurimit synojnë të sigurojnë se fondet publike përdoren në mënyrë transparente dhe efikase për të arritur vlerën për para. Korniza ligjore përcakton qartë të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve të përfshira në menaxhimin e prokurimit. Kjo përfshin kërkesën për të ulur rrezikun e mos përfundimit të kontratave dhe të ekzekutimit e tyre të dobët. Kjo arrihet përmes zbatimit të një regjimi gjatë vlerësimit të ofertave për të siguruar që operatorët ekonomik të përgjegjshëm janë përzgjedhur. Gjatë auditimit tonë, ne kemi identifikuar çështjet si në vijim.

Çështja 4 - Dobësi në prokurim - Prioriteti i lartë

E gjetura

Vlerësimi i ofertave nga komisionet vlerësuese nuk ishte kryer në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik dhe si pasojë dhënia e kontratave ishte bërë në mungesë të Operatorëve Ekonomik (OE) të përgjegjshëm. Në dy (2) aktivitetet e prokurimit të cekura më poshtë ofertat e OE nuk ishin vlerësuar si duhet, në veçanti nuk janë respektuar kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit si dhe korniza ligjore e LPP-së.

Aktiviteti i prokurimit "Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të IT". Sipas njoftimit për kontratë[4] nga OE-të kërkohej që për tre vitet e fundit (2012-13-14) të kenë të kryer së paku tre kontrata për shitje dhe mirëmbajtje të klimatizimit industrial dhe konvencional. Përkundër kësaj, kontrata i është dhënë ofertuesit i cili kishte dëshmuar vetëm dy nga tre kontratat e kërkuara.

Aktiviteteti i prokurimit "Rishikimi i sistemit aktual të regjistrimit të bizneseve me qëllim të krijimit të një numri unik të biznesit". Në njoftimin për kontratë dhe sipas dosjes së tenderit, kërkohej nga OE që ekspertët e propozuar të kenë 10 vite përvojë pune ndërkombëtare, rajonale ose të brendshme në ofrimin e shërbimeve të konsulencës për sistemin e regjistrimit të bizneseve dhe unifikimin e sistemeve për identifikim të bizneseve[5]. Mirëpo kriteri i përvojës ishte i specifikuar në një fushë të ngushtë të ekspertizës. Si pasoj, komisioni vlerësues nuk e kishte sigurinë e mjaftueshme nëse ekpertët e propozuar e plotësonin këtë kërkesë.

Megjithatë, ata kishin përvojë të përgjithshme në fushën e reformave të administratës publike por ishte vështir të vlerësohet nëse përvoja e tyre shtrihej edhe në fushën e kërkuar. Andaj në rastet e ngjashme në të ardhmen , rëndësi më e madhe duhet kushtuar hartimit të kërkesave të realizueshme.

[4] **Aktiviteti i prokurimit "Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të IT" kriteri:** Pika- III. 2. 24 kapacitetet teknike dhe profesionale
[5] Dosja e tenderit (seksioni 2. Fleta e të dhënave të tenderit), neni 9.1. kërkesat për ekspertin e propozuar nga operatori ekonomik.

Rreziku Dobësitë lidhur me hartimin e kërkesave të prokurimit dhe vlerësimit të tenderëve rrezikojnë vështirësi në zhvillimin e procesit, përzgjedhjen e përfituesit jo më të mirë të mundshëm, ofrimin e shërbimeve jo cilësore si dhe realizimin e objektivave të planifikuara të MF-së.

Rekomandimi 4 Ministri duhet të siguroj përmes Sekretarit të Përgjithshëm se janë forcuar kontrollet e brendshme rreth përpilimit të dosjes së tenderit dhe të vlerësimit të ofertave për të siguruar prokurime efektive dhe përzgjedhjen e ofertave më të mira të mundshme.

Çështja 5 - Dobësi jo sistematike në procesin e pagesave - Prioritet i lartë

E gjetura **Furnizim me material të pa kontraktuar.** MF ishte furnizuar me 26 artikuj material për zyre në vlerë prej 2,588€ por të cilat nuk ishin pjesë e kontratës dhe as të dosjes së tenderit.

Kontrollet jo efektive gjatë procedimit të pagesave për shërbimet e përkthimit. Çmimi i kontratës për faqe për "Shërbime të përkthimit dhe lektorimit të materialeve nga gjuha shqipe, angleze, serbe dhe anasjelltas" ishte 6.10€. Gjatë testimit të pagesës në vlerë prej 9,765€ kemi vërejtur që pagesa ishte kryer në mungesë të dëshmive të plota për materialet e përkthyera. Dëshmitë e ofruara mbulonin vetëm përkthimin e materialeve në vlerë prej 6,646€.

E vlen të ceket që MF, pas pranimit të draft raportit të auditimit ka zbatuar ndalesën tek OE për shumën e mbi paguar. Për këtë MF ka ofruar dëshmitë përkatëse.

Rreziku Kontrollet jo efektive gjatë pranimit të mallrave dhe procedimit të pagesave kanë pasur për pasoj furnizimin me mallra jashtë kontratës dhe pagesën për shërbimet e papranuara të përkthimit. Kjo përveç që është shkelje e kërkesave ligjore po ashtu rrit rrezikun për keq përdorim të parasë publike.

Rekomandimi 5 Ministri duhet të siguroj se ka forcuar kontrollet ekzistuese me rastin e pranimit të mallrave dhe në sektorin e pagesave për të evituar pranimin e mallrave të pa kontraktuara dhe pagesën për shërbimet e papranuara.

Çështja 6 - Mos respektim i LPP-së dhe ligjit të ATK-së-Prioritet i lartë

E gjetura

Për menaxhimin e financave publike, Thesari përdor sistemin e Freebalancit SIMFK të dizajnuar dhe në pronë të një kompanie kanadeze. Për këtë, Thesari paguan tarifën vjetore. Kontrata e parë për përdorimin e licencës dhe mirëmbajtjen e sistemit ishte nënshkruar në vitin 2001, në kohën e administrimit të UNMIK-ut. Dhe që, nga ai vit, Thesari në vazhdimësi ka lidhur kontrata dyvjeçare me të njëjtën kompani.

Në këtë kontekst, në janar 2015 Drejtori i Thesari kishte nënshkruar kontratë të re me pronarin e njëjtë të sistemit duke përdorur procedurën e negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës. Derisa, përdorimi i kësaj procedure është në rregull dhe i domosdoshëm, zbatimi i saj është përcjell me disa lëshime të natyrës procedurale. Në mesin e tyre, kontrata është nënshkruar vetëm nga Drejtori i Thesarit por jo edhe nga Ministri[6]. KRPP nuk është njoftuar për përdorimin e kësaj procedure ndërsa kushtet dhe termet e kontratës nuk ishin rregulluar në mënyrë specifike sidomos pagesa e tatimeve[7]. Thesari nuk ka ofruar dëshmi që OE ndërkombëtar kishte përfaqësues fiskal të regjistruar në Kosovë për çështje të obligimeve tatimore. Sipas kërkesave ligjore të ATK-së[8], OE ndërkombëtar duhet ta ketë përfaqësuesin fiskal të regjistruar në Kosovë, pagesa të kryhet përmes përfaqësuesit dhe çmimi të përfshij TVSh.

MF për vitin 2015 kishte paguar tarifën prej 280,106€ drejtpërdrejt në llogari të OE të jashtëm dhe në këtë çmim nuk ishte kalkuluar TVSh.

Ia vlen të theksohet se, MF është zotuar në eliminimin e lëshimeve të identifikuara në kontratën që do të vazhdohet për vitet në vijim.

Rreziku

Lëshimet procedurale të bëra gjatë zhvillimit të procesit të prokurimit mund të shkaktojnë vështirësi në implementimin e kontratës duke ndikuar efikasitetin e kontratës, vlerën e parasë së shpenzuar si dhe në mos mbledhjen e tatimit të duhur.

Rekomandimi 6

Ministri duhet të siguroj se ka kryer një rishikim të gjithanshëm të kësaj kontrate dhe të ndërmerr veprimet e duhura që kontrata të trajtohet brenda kornizave ligjore të prokurimit.

[6] Sipas nenit 26 të LPP-së, pika 2 nënshkrimi i kontratave publike përveç nënshkrimit të zyrtarit përgjegjës të prokurimit, tek kontratat me vlerë të mëdha duhet që gjithashtu të nënshkruajnë ZKA dhe Ministri.

[7] KRPP duhet të njoftohet nga autoriteti kontraktues në fjalë brenda dy ditëve nga data kur merret vendimi për fillimin e kësaj procedure.

[8] Sipas nenit 11, të ligjit të ATK-së pika 5 e nenit 11. Çdo person jo-rezident i cili i nënshtrohet çfarëdo tatimi në Republikën e Kosovës në pajtim me legjislacionin tatimor të vendit, do të caktojë një përfaqësues fiskal përpara se të fillojë me përmbushjen e kontratës.

3.6 Shpenzimet jo përmes prokurimit

3.6.1 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

MF, në fund të vitit 2015 kishte të punësuar 1599 punonjës dhe kishte paguar 14,369,591€ në emër të pagave dhe mëditjeve.

Ne kemi testuar kryesisht procesin e rekrutimit, listat e pagave dhe procesin e gradimeve. Krahasuar me vitin paraprak, MF kishte ndërmarr masa në forcimin e kontrolleve gjatë avancimit dhe rekrutimit të stafit. Megjithatë, kjo fushë duhet të zhvillohet edhe më tutje për të siguruar evitimin e mbulimit të pozitave udhëheqëse me ushtrues detyre përtej afateve ligjore dhe pagesën e stafit sipas numrit të stafit të aprovuar me ligjin e buxhetit. Testet tona kanë identifikuar mangësitë në vijim.

Çështja 7 – Mangësi në menaxhimin e burimeve njerëzore - Prioriteti i lartë

E gjetura

Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre (UD) për periudhë më të gjatë se kërkesat ligjore. Sipas Ligjit për Shërbimin Civil në nenin 30" Zëvendësimi i nëpunësit civil në rast të mungesës" në pikën 4 ceket se "Në rast të mbetjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj".

Pozita e drejtorit të departamentit ligjor është mbuluar me UD nga data 11/09/2013 duke e tejkaluar limitin e lejuar prej 3 muaj për një kohë të konsiderueshme.Gjithashtu me UD mbulohet edhe pozita udhëheqëse e divizionit te politikave fiskale. Ne duhet të theksojmë që, MF ka shpallur konkurse për këto pozita tri herë megjithatë përkundër përpjekjeve ende nuk ka arritur të bëjë zgjidhje të përhershme.

Organizimi dhe sistemimi i brendshëm i të punësuarve nuk ishte në pajtim me numrin e aprovuar të personelit sipas ligjit të buxhetit. Pagesa e pagave për shtatë (7) të punësuar në kabinetin e ministrit nuk bëhej nga buxheti i sektorit përkatës, por nga departamenti i i administratës.

Sipas Ligjit të buxhetit për 2015 neni 10- limitet në zotime dhe shpenzime, asnjë organizatë buxhetore nuk mund të tejkaloj numrin e pozitave të punësimit në nivele të nën-programit për nivelin qendror në asnjë kohë gjatë vitit fiskal 2015 të specifikuara në tabelën 3.1 dhe 3.1 A.

Rreziku Mbulimi i pozitave me UD si dhe angazhimi i stafit në më shumë se një pozitë mund të rrisin rrezikun në dështimin e përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive përkatëse. Ndërsa, buxheti i ndarë për departamente i ndikuar negativisht nga pagesa e pagave për stafin e departamentit tjetër, mund të rrezikoj pagesën vjetore të pagave për personelin e atij departamenti.

Rekomandimi 7 Ministri duhet të siguroj se janë ndërmarr të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave të caktuara me punëtorë të rregullt. Më tutje, duhet të siguroj se shpërndarja e personelit përbrenda institucionit është në harmoni me limitet e lejuara të të punësuarve sipas programeve të parapara me Ligjin e Buxhetit.

3.6.2 Subvencionet dhe Transferet

MF për vitin 2015 ka kryer pagesa nga kategoria e subvencioneve në vlerë prej 3,103,321€. Prej tyre, 1,138,060€ janë paguar për subvencionimin e polisave të sigurimit, 1,472,909€ janë paguar për provizionet bankare ndaj bankave komerciale lidhur me shpërndarjen e pensioneve për përfituesit e skemës sociale, 399,597€ për vendime gjyqësore dhe 92,755€ për subvencionimin e entiteteve jo publike.

Vite me radhë, ZAP ka dhënë rekomandimin që pagesat për provizione bankare të kryhen nga buxheti për mallra dhe shërbime dhe meqenëse skemat pensionale janë aktivitet i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) buxheti për këto pagesa duhet të bartet në MPMS.

Megjithatë edhe këtë vit sikurse edhe në vitet e mëparshme, shpenzimet për pagesën e provizioneve bankare janë buxhetuar në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve në MF. Dhe, rrjedhimisht edhe pagesat për provizione janë ekzekutuar nga kjo kategori.

Megjithatë, me Ligjin e buxhetit për 2016 nr. 05/L-071, buxheti për këto shpenzime është transferuar në MPMS.

Rekomandim

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.7 Pasuritë dhe detyrimet

3.7.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas regjistrit kontabël të pasurisë, vlera neto e pasurisë kapitale të MF dhe Agjencioneve të saja vartëse është 7,426,000€. Pasuria financiare jo-kapitale e administratës së MF-it nën 1000€ ishte regjistruar në sistemin e-pasuria, por jo edhe stoku. Përderisa, Thesari këtë sistem e kishte përdorur vetëm pjesërisht duke regjistruar në sistemin e pasurisë vetëm pasuritë nën 1000€ të blera gjatë vitit 2014 dhe 2015. Në fund të vitit, ishte bërë edhe njehsimi fizik apo inventarizimi i pasurisë.

Çështja 8 - Mos përdorimi i programit e-pasuria- Prioritet i mesëm

E gjetura	Administrata e MF-it nuk kishte mbajtur evidenca për gjendjen e stokut në sistemin kontabël e-pasuria. Më tutje, Thesari në sistemin kontabël kishte regjistruar vetëm pasurinë e blerë nga viti 2014 dhe 2015 por jo edhe pasurinë nga vitet e mëhershme. Ndërsa, në AQP moduli i zhvlerësimit për vitin 2015 nuk kishte funksionuar për të bërë përllogaritjen e zhvlerësimit të akumuluar për vitin.
Rreziku	Dobësitë e cekura më lartë vështirësojnë përdorimin dhe menaxhimin adekuat të pasurisë dhe materialit shpenzues. Në këtë rast, edhe informatat financiare ekzistuese mund të mos përmbushin kërkesat e kontabilitetit dhe raportimit financiar.
Rekomandimi 8	Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerr veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Zyrtarëve përgjegjës t`u ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.

3.7.2 Trajtimi i borxheve

Përshkrim

Pasqyra e obligimeve të papaguara në fund të vitit 2015 ishte në shumën 10,430€. Këto detyrime janë bartur për tu paguar në vitin 2016. MF ka instaluar një sistem të qëndrueshëm në trajtimin e faturave të papaguara dhe ekzekutimin e pagesave. Vlera e mbetur e obligimeve të papaguara reflekton kryesisht pagesat për shpenzime mallra dhe shërbime si dhe shpenzime komunale të cilat procedohen për pagesë në muajin vijues.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinioni i auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditivit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçë për të cilat Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuara të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuara gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarim materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarim materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarimmateriale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarim materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarim materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimtë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinioni mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarim materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të implementuara	Të adresuara por jo te implementuara	Të pa adresuara
1. Adresimi i rekomandimeve nga vitet paraprake.	Ministri duhet të zbatojë një proces të qartë për monitorimin e adresimit të rekomandimeve të AP-së. Rekomandimet të cilat nuk adresohen sipas afateve, të rishikohen në baza mujore nga Ministri , si dhe veprime pro aktive të ndërmerren ndaj sfidave të paraqitura gjatë zbatimit.		Të adresuara por jo plotësisht të implementuara	
2.Realzimi i buxhetit për projekte kapitale	Ministri duhet të siguroj që ka kryer një vlerësim sistematik të arsyeve në lidhje me nivelin e ulët të ekzekutimit të buxhetit për investime kapitale, për të identifikuar me kohë arsyet dhe të marr masa për evitimin e mangësive qoftë në fazën e planifikimit apo të ekzekutimit të buxhetit.	Të implementuara		
3.Keq klasifikimi i buxhetit provizione bankare	Ministri duhet të siguroj se ka instaluar kontrolle shtesë në fazën e buxhetimit të projekteve, për të mundësuar më pas klasifikimin, regjistrimin dhe raportimin e shpenzimeve në pajtueshmëri me planin kontabël.	Të implementuara		

4.Dobësi i sistematike në proceset e prokurimit.	Ministri duhet të siguroj se ka kryer një rishikim të brendshëm për të përcaktuar shkaqet, pse procedurat adekuate të prokurimit nuk janë aplikuar në të gjitha rastet dhe të forcoje kontrollet për të siguruar se dobësit e identifikuara janë adresuar. Po ashtu, duhet të siguroj se janë forcuar masat e përgjegjësisë sa i përket aktiviteteve të kontrollit si dhe ndarja e detyrave të jetë në pajtueshmeri me rregullativën ligjore.			Të pa adresuara
5.Mangesi ne menaxhimin e projeketit kapital	Ministri duhet të siguroj se në rastet e financimit të projekteve të rëndësishme dhe me vlera të mëdha materiale të ndërmerr masa preventive me qëllim që mangësitë e identifikuara në projektin e Fabrikës së ujit të mos përsëriten në të ardhmen.	Të implementuara		
6.Mos mbyllja e avanceve për udhëtime zyrtare	Ministri duhet të sigurohet së janë ndërmarr masat e duhura në kthimin e fondeve të paarsyetuara	Të implementuara		
7.Dobësi i sistematike në menaxhimin e personelit	Ministri duhet të sigurojë se me rastin e avancimit të stafit respektohen kriteret që kanë të bëjnë me afatet kohore dhe përvojën e duhur profesionale për t'u graduar në pozitën e caktuar. Po ashtu janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për mbulimin e pozitave me punëtor të rregullt si dhe shpërndarja dhe pagesa e personelit përbrenda Ministrisë duhet të jetë në harmoni me limitet e lejuara të të punësuarve sipas programeve të parapara me Ligjin e Buxhetit.		E adresuar por jo plotësisht të implementuara	

8.Pagesa e provizioneve bankare pa kontrat.	Ministri duhet të siguroj se shpenzimet e planifikuara për provizione bankare menaxhohen duke u mbështetur në bazën e qartë ligjore dhe po ashtu të siguroj që zyrtarët përkatës kanë shtuar kujdesin gjatë llogaritjes së provizioneve me qëllim që ato të jenë të sakta dhe të bazuara në kontratë.	Të implementuara		
9.Mos përdorimi i programit E –Pasuria	Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Zyrtarëve përgjegjës t`u ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.			Të pa adresuara
10.Pagesa e shpenzimeve nga fondi parasë se gatshme	Ministri duhet të siguroj se fondi i parasë së gatshme shfrytëzohet vetëm për nevojat dhe kërkesa të paparashikuara, duke i paraprirë një proces ligjor i aprovimit për arsyeshmërin e shpenzimit.		Të adresuara por jo plotësisht të implementuara	